



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), Neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës për punën e Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar ndaj lëndës së formuar pas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në vazhdimin e seancës së 60-të, të mbajtur më 31.01.2022, miratoi si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1874/1 datë 04.05.2020, e cila shpreh dyshimin për prerje joligjore të drunjtëve -----, **REFUZOHET.**

KSHPK-ja konstatoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, në denoncim nuk ka pretendime të qarta për veprime të paligjshme ose të palejueshme të personit zyrtar në ushtrimin e autoritetit publik dhe detyrës zyrtare, dhe meqenëse denoncimi është anonim, KSHPK nuk ka mundësi të ofrojë informata shtesë për pretendimet në të njëjtën.

Lënda me numër 12-1874/1 të datës 04.05.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur më datë 04.05.2020 është dorëzuar denoncim me dyshimin për prerje të paligjshme të drunjtëve ----- dhe është formuar rasti me numër 12-1874/1 i datës 04.05.2020. Në denoncim, parashtruesi deklaron se ai ishte dëshmitar i automjeteve të shumta që ishin ngarkuar me pemë të prera ilegalisht në ----- . Grupet që i prenë përdornin automjete të paregjistruara. Denoncimi është dorëzuar edhe në Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrisë së Mjedisit Jetësorë.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në lëndë, KSHPK konstaton se në rastin nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të saktësuar pretendimet e denoncuar, gjegjësisht, nuk ka informacione nëse personat zyrtarë në kuptim të nenit 8 paragrafi 2 nga LPKKI janë përfshirë në veprimet e përmendura, por theksohet se një grup i caktuar i ka kryer veprimet e kundërligjshme dhe në të njëjtën kohë KSHPK-ja nuk ka mundësi të siguron informata shtesë për pretendimet në denoncim sepse bëhet fjalë për denoncim anonim.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: S.M

Miratoi: M.r .SH.S, Anëtar i KSHPK-së

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија

Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut

email: contact@dksk.org.mk

тел/tel: +389 2 3248 930

<https://www.dksk.mk>

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОР
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
Нёнкрыетар
Goran Trpenoski

